

Solidariteti i Toskanës: ndihma nga Rajoni i Toskanës për familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara

Ligji Rajonal Toskana n. 73/2018

Rajoni i Toskanës ka vendosur të ndihmojë familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara me një kontribut vjetor të barabartë me 700.00 euro për çdo fëmijë me aftësi të kufizuar, të cilët prezantojnë konstatimin e gjendjes së rëndë të aftësive të kufizuara/handicap me referim nenin 3, pika 3. i ligjit 5 shkurt 1992, n. 104 (Ligji-situata për asistencën, integrimin social dhe të drejtat e personave handicapate). Me qëllimin e dhënjes së kotributit është konsideruar i mitur dhe fëmija i cili mbush tetëmbëdhjetë vjeç në vitin të cilit i referohet kontributi.

Aplikimi mund të prezantohet nga nëna ose babai i të miturit me aftësi të kufizuar, ose nga kush ushtron fuqinë prindërore, panvarsisht nga ngarkimi fiskal, me kusht që prindi duhet të bëjë pjesë në trungun familiar të fëmijës me aftësi të kufizuar për të cilin kërkohet kontributi.

Si prindi, si fëmija me aftësi të kufizuara duhet të jenë banues/rezidentë në Toskanë, në mënyrë të vazhdueshme prej të paktën njëzet e katër muajve, në banesa jo të zëna në mënyrë abuzive, duke filluar nga data e 1 janarit të vitit të cilit i referohet kontributi.

Prindi i cili prezanton kërkesën dhe fëmija me aftësi të kufizuara duhet të bëjnë pjesë në trungun familjarë me një vlerë treguese të situatës ekonomike ekuivalente (ISEE) jo më të lartë se 29.999,00. Euro.

Gjithashtu prindi i cili prezanton kërkesën nuk duhet të ketë marrë dënime me vendim të prerë për krime si bashkpunimi mafioz, pastrim parash dhe përdorimi i parave, pasurive ose dobive të tjera me prejardhje të jashtligjshme nenet 416 bis, 648 bis e 648 të kodit penal.

 [Modulari i kërkesës \(102.71 KB\)](#)

 [Modulari privacy \(83.11 KB\)](#)

Ku të prezantoni kërkesën

Aplikimet duhet të prezantohen në [Sportelin multifunksional](#) brenda **30 qeshorit** të çdo viti të cilit i referohet kontributi.

Është e nevojshme të bashkangjitni:

- kopien ISEE të vlefshme
- kopien e dokumentit të identitetit të kërkuarit
- n.q.f është i huaj, bashkangjitni edhe kopjen e lejes së qëndrimit/ kartës së qëndrimit
- çertifikatën L. 104/1992 lidhur me të miturin

[lidhja me faqen e internetit të Rajonit të Toskanës “Solidariteti i Toskanës”](#)